

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: Gjuhë angleze

(klasa e katërt)

Tiranë, 2005

I. TË PËRGJITHSHME

Mësimi i gjuhës angleze në klasën IV vjen pas një viti pune që është përqendruar në :

- a) ndërgjegjësimin e fëmijës për mësimin e gjuhës së huaj,
- b) njohjen e nxënësit me elementet fillestare të një gjuhe të huaj,
- c) përvetësimin e mjaft fjalëve, të shprehjeve dhe elementeve gramatikore të thjeshta, të cilat në një pjesë të ndjeshme janë në formën e elementeve gojore.

Nxënësit shkojnë në klasën IV me disa ndryshime në aspektin gjuhësor në lidhje me gjuhën amtare, e cila do t'u mundësojë kuptimin e mjaft elementeve të gjuhës së huaj. Ata në këtë moshë janë ndërgjegjësuar për shumë rregulla gjuhësore morfologjike dhe sintaksore. Duke patur parashysh këto dhe njohuritë e marra në klasën III në gjuhën angleze, nxënësit fillojnë t'u kushtojnë më shumë rëndësi elementeve të shkruarit.

Përmes ecurisë të të mësuarit të gjuhës së huaj angleze në klasën IV të shkollës fillore, nxënësit i jepet mundësi të njihet me më shumë elemente të kulturës, simbole dhe shprehje të caktuara të kësaj gjuhe.

II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE

Mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhës angleze në moshë të vogël:

- ndihmojnë në formimin e përgjithshëm të nxënësit;
- shfrytëzojnë aftësitë moshore psikike dhe fizike, të cilat i mundësojnë aftësinë për të përgjithësuar dhe për të përmbledhur atë që mësojnë gjatë orës së gjuhës së huaj;
- rritin aftësinë për të artikuluar qartë dhe për të shprehur veten në mënyrë krijuese, duke treguar se mund të kuptojë fjali të shkurtra në gjuhë të huaj;
- ndihmojnë në rritjen e aftësive intelektuale dhe përfshirjen e tij në dialogje të thjeshtë nga jeta e përditshme.

Mësimi i gjuhës së huaj në këtë klasë dhe grup-moshë shihet si periudha më e përshtatshme për t'i nxitur drejt diçkaje të re, siç është të nxënët të gjuhës duke e trajtuar atë si lojë, pjesë të kreativitetit të tyre, pra çfarë u ofron dhe çfarë mund të bëjnë nëpërmjet gjuhës së huaj.

Mësimi i gjuhës angleze në këtë moshë synon:

1. T'i përcjellë nxënësit bazat fillestare të mësimin të një gjuhe të huaj dhe ta përjetojë gjuhën si mjet komunikimi dhe po si të tillë ta përdorë atë;
2. Të ndihmojë në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit në aspektin njohës, gjuhësor dhe emocional;
3. Ta aftësojë nxënësin për të dëgjuar, për të riprodhuar, për të kuptuar dhe për të krijuar disa elemente të thjeshta të gjuhës së huaj;
4. Të nxisë te nxënësi dëshirën për të pyetur, për t'u përgjigjur, për të përshkruar objektet e mjedisit rrethues, për të kuptuar gjuhën e përdorur nga mësuesi në klasë.

III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE

Duke iu referuar "Vizionit kurrikular 2004" për arsimin nëntëvjeçar, përshkrimet e niveleve synojnë të përcaktojnë arritjet e nxënësit duke dhënë formulime të përgjithshme të përvetësimin të gjuhës së huaj. Përshkrimi i një niveli të vetëm është një tregues i

përvetësimin të gjuhës nga nxënësi. Mësuesi i përdor përshkrimet e niveleve për të përcaktuar shkallën e përvetësimin të nxënësit. Mënyra më e dobishme për të përdorur përshkrimet e niveleve është marrja parasysh e shkallës së përvetësimin që pritet për çdo grup-moshë.

Shprehinë gjuhësore të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit të intergohen gjatë të gjithë procesit mësimor.

Të dëgjuarit

- Nxënësi me ndihmën e mësuesit apo të figurave kupton dhe reagon ndaj tregimeve apo teksteve të shkurtëra.
- Nxënësi dëgjon dhe kupton pjesë të thjeshta të lexuara ngadalë dhe me gjuhë të qartë dhe kërkon t'ia përsëritë mësuesi kur ka paqartësi.
- Nxënësi u kushton rëndësi shqiptimit dhe intonacionit të modeluar nga mësuesi ose nga mjetet audiovizive dhe kërkon përsëritje kur është e domosdoshme.

Të folurit

- Nxënësi jep përgjigje të shkurtëra për pyetje të drejtuara për të shprehur diçka që i pëlqen ose jo.
- Nxënësi bën pyetje dhe merr pjesë në dialogje të shkurtëra që kërkojnë përgjigje të menjëhershme për pjesë të mësuara më parë, si: përshëndetje, miratim, ftesë etj

Të lexuarit

- Nxënësi lexon dhe kupton tekste të shkurtëra, që përmbajnë fjalë dhe fraza të shkurtëra me fjalor të njohur.
- Nxënësi tregon besim në të lexuarit me zë të lartë të pjesëve të shkurtëra
- Nxënësi fillon të lexojë në mënyrë të pavarur tekste shumë të thjeshta.

Të shkruarit

- Nxënësi kopjon fjalë ose fraza të shkurtëra dhe dallon gabimet.
- Nxënësi shkruan fjalë dhe fjali të thjeshta të mësuara përmendësh.
- Nxënësi në fund të klasës IV shkruan paragrafë të shkurtër për materiale të njohura duke përdorur gjuhë të thjeshtë përshkruese

Shëmbuj për përdorimin praktik të programit për aftësitë gjuhësore

Të dëgjuarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha, struktura
Nxënësi dëgjon dhe kupton pjesë të thjeshta	Veprimtaritë e përditshme.	Kupton dhe reagon ndaj	Ndjek dhe përshkruan	Kupton dhe përdor foljet

të lexuara ngadalë dhe me gjuhë të qartë dhe kërkon përsëritje nga kur ka paqartësi ndaj udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit.	Tema: Daily routine at home	udhëzimeve bazë të dhëna në klasë.	veprimtari të jetës së përditshme.	në kohën e tashme: I do my bed, I watch TV after school; I play with my friends
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------	------------------------------------	------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------

Të folurit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha, struktura
Nxënësi jep përgjigje të shkurtëra për pyetje të drejtuara për të shprehur diçka që i pëlqen ose jo.	Jeta vetjake dhe shoqërore. Tema: Unë, familja dhe shokët	Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të shkurtëra për veten.	Jeta familjare. Merr dhe jep informacion për vendin ku ndodhet, gjendjen shëndetësore etj., etj.	Përdorimi i kohës së tashme "I live in Butrint. Where do you live? I do not live in Butrint, I live in Gjirokastra"

Të lexuarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha, struktura
Nxënësi lexon dhe kupton tekste të shkurtëra, që përmbajnë fjalë dhe fraza të	Jeta vetjake dhe shoqërore. Tema: Trupi i njeriut	Kërkon dhe jep informacion për veten, shokët dhe familjen.	Trupi i njeriut. Lexon, lidh dhe kupton emërtimin e pjesëve të trupit sipas	Pjesët e trupit dhe krahasimi i mbiemrave "The eyes of Mira are bigger than Era's.

shkurtëra me fjalor të njohur.			tekstit etj.	The shoulders of Agim are wider than Arjan's ”.
--------------------------------	--	--	--------------	-------------------------------------------------

Të shkruarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha, struktura
Nxënësi kopjon fjalë ose fraza të shkurtëra, dhe dallon gabimin. Nxënësi shkruan fjalë dhe fjali të thjeshta të mësuara përmendësh.	Marrëdhëniet vetjake dhe shoqërore. Tema: Jeta në familje.	Shkruan për elemente vetjake dhe vendin ku ndodhet. Plotëson një fjali dhe shkruan një pjesë të mësuara përmendësh.	Jeta në familje. Kopjon fjalë e fraza të shkurtëra si mjet për të mësuara. Shkruan fjali të shkurtëra të diktuar nga mësuesi.	Drejtshkrimi i fjalëve të veçanta dhe frazave të shkurtëra. Gërmëzimi I disa fjalëve në fjali.

IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1) Sfera tematike dhe leksiku

Every day life

Daily routine at home (get up, make my bed, brush my teeth, wash my face, go to school, have meals etc.)

Food and drink (meals, breakfast, lunch, supper)

Year, Month, dates (seasons, days of the week, dates)

Important dates holidays: summer holidays and school holidays. birthdays and birthday parties

2. School life

My school uniform

Mathematics : numbers from 20-100, addition and subtraction.

3. Personal and social life

Self, family, friends

Human body

Professions
Health
Family relationship

4. The world around us

Home town, addresses
Home country

5. The world of communication

Letters and postcards
Phones and Phoning.

2)Aktet / funksionet komunikuese

Describing everyday activities.

For example:

I watch TV after school. Then I do my home work.

Narrating.

For example: Yesterday I played soccer. After that, I bought an ice cream.

Making comparisons.(short adj. with -er)

For example:

I am taller than Agim.

Agim is older than me.

Expressing likes and dislikes

For example:

I like movies very much.

I don't like to read.

Inviting.

For example:

Can you come to my birthday party?

Yes I can.

Please come to my party?

Talking about ownership.

For example:

For example:

This is my book.

This is her pen.

Asking and answering simple personal questions.

For example:

For example:

How are you? I'm fine, thanks.

Where do you live? I live in Saranda near Butrint.

What's your adress?

what's your phon number?

Exchanging courtesies.

For example:

Thank you very much.
That's very kind of you.
You are welcome.

Asking permission

For example:

May I go outside.
Can I open the window?

Describing the weather.

For example:

What's the weather like? It's a fine day. It's raining. It's sunny.

Making phone calls.

For example:

Hello! 22 53 89. This is Pol speaking.
It's me. who is this?
Just a minute please.

Talking about sizes.

For example:

what size is it? It's large. It's medium. It's small. It's size 36
What size do you wear your blouse? Small (S) medium(M) large (L)
extralarge (XL)
My size is small (S) medium(M) large (L) extralarge (XL)
My mother /mum wears large, my father/ dad extra larg)

3) Elemente dhe struktura gramatikore

Revision of the material learned in the third grade.

- Simple present.(short forms, interrogative, negative)
- Simple past.(Regular verbs, short forms, affirmative, interrogative, negative)
- Comparison of the adjectives. (- er..than)
- Prepositions of location. (In front of, behind, beside next to, above, between, under, in, on etc.)
- Modal *May* for permission. For Example: May I go out?
- Countable and uncountable nouns; much, many, few, a little, Not much, many. For example: There are many books on the table;
- These, those (and revieë of this that)
- Possessives : For example: This is mine. It is yours?
- The (definite article)

4. Shpërndarja e orëve

35 javë x 2 orë = 70 orë

Aspekti komunikues-kulturor:	32 orë
Aspekti gjuhësor:	28 orë
Të lira:	10 orë
<i>Gjithsej:</i>	70 orë

Aspekti komunikues- kulturor (32 orë). Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, përgjithësisht këshillohet që afër 32 orë mësimore t'u kushtohen veprimtarive me karakter komunikimi, përfshirë këtu të ushtruarit, në situata komunikuese, të njohurive, strukturave, nocioneve që ngërthejnë materialet e ndryshme didaktike, si: teksti, materiale integruese etj., rimarrjen dhe përsëritjen e njohurive të fituara deri në atë pikë, rimarrjen dhe përfundimin deri në ngulitje të funksioneve, nocioneve e strukturave komunikuese më të rëndësishme.

Aspekti gjuhësor (28 orë). Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi ftohet të shtjellojë, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore, ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore), rimarrje dhe përfundim të njohurive të mësuara më parë apo edhe të reja.

Të lira (10 orë). Në këto orë të lëna në dispozicion të mësuesit, mund të zhvillohen orë përsëritjeje, detyra kontrolli, plotësim të orëve kushtuar aspektit qoftë komunikues, qoftë gjuhësor.

V. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Realizimi i objektivave të programit mbështetet në:

Krijimin e një mjedisi të të mësuarit në mënyrë joformale

Respektimi i aftësive moshore, psikike, fizike dhe intelektuale të nxënësit është një domosdoshmëri për të garantuar suksesin në punën me këtë grup-moshë.

Nxënësit e kësaj grup-moshe mësojnë më mirë në mjedise joformale. Mësuesi nuk mbështetet vetëm tek e foluara, por duke u krijuar nxënësve një mjedis ku të ketë lëvizje dhe pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme.

Në këtë orë mësimi mësuesi duhet të përdorë mjete të larmishme, pra jo vetëm tekstin, por edhe piktura, objekte rrethore që ngjallin interes te nxënësi dhe i nxitin krijimtarinë.

Shumëllojshmërinë dhe vetëshprehjen e nxënësve

Në çdo orë mësimi, kreativiteti i nxënësve dhe shprehja e tyre duhet të nxitin nëpërmjet veprimtarive dhe detyrave që zgjerojnë imagjinatën.

Detyrat e dhëna të jenë brenda aftësive të tyre, pra të jenë të realizueshme, por në të njëjtën kohë edhe nxitëse.

Është i domosdoshëm përdorimi i metodave sa më të larmishme dhe i mjeteve përkatëse didaktike.

Në këtë moshë nxënësit ndihen më të aftë në përdorimin e gjuhës amtare dhe mund të planifikojnë veprimtari të thjeshta. Nën kujdesin e mësuesit mund të përdorin arsyetimin e tyre logjik, mund të përdorin një imagjinatë të gjallë, mund të imitojnë duke përdorur intonacione të ndryshme.

Rëndësinë për ndërgjegjësimin e nxënësit për gjuhën e huaj

Kërkohej kohë që nxënësi të ndërgjegjësohet për gjuhën e huaj si një veprimtari e veçantë nga ato që ai kryen përditë në shkollë. Ai në këtë moshë është ndërgjegjësuar mjaft për gjuhën amtare. Në gjuhën e huaj ky ndërgjegjësim vjen shkallë-shkallë si rrjedhojë e shoqërimit të gjuhës së folur me shpjegime nga ana e mësuesit, me përdorimin e gjesteve, lëvizjeve etj. Kur nxënësit fillojnë të lexojnë gjuha bëhet më e

pranishme dhe nuk nevojiten elementet e mësipërme. Një pjesë e shkurtër për t'u lexuar në klasë dhe shtëpi do t'i bëjë nxënësit të kuptojnë më shumë se ç'është gjuha e huaj. Po kështu, edhe me të shkruarit. Pra, të shkruarit dhe të lexuarit janë shumë të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e nxënësit për gjuhën e huaj dhe për progresin e tyre në këtë lëndë. Gjithashtu, nxënësi do të ndërgjegjësohet edhe për faktin se të shkruarit dhe të lexuarit kërkojnë kujdes dhe përkushtim.

Njohjen me gramatiken

Nxënësit e kësaj grup-moshe kanë një aftësi të jashtëzakonshme për të përvetësuar gjuhën (gramatikën) edhe për faktin se gjuha amtare në këtë stad i ndihmon mjaft të kuptojnë konceptet gramatikore.

Mësuesi duhet të përcaktojë strukturat, funksionet që dëshiron t'u sqarojë nxënësve dhe këtë ta bëjë në mënyrë të tërthortë. Gramatika është e rëndësishme, nxënësit e pëlqejnë sepse u tregon rritjen e nivelit të tyre gjuhësor, por disi frenuese për nxënësin nëse jepet dhe kërkohet teorikisht.

Koha më e përshtatshme për t'u mësuar nxënësve elementet gramatikore është kur pyeten për ndonjë element të veçantë gjuhësor. Në këtë moshë nxënësit bëjnë pyetje të tilla, si: Ku ndryshojnë "Does and Did", meqë të dyja përdoren për të pyetur?

Duke patur parasysh se jo gjithmonë gjuha amtare të ndihmon, këshillohet që këto të shpjegohen me shembuj të shumtë dhe, nëse në grupe të mëdha ka probleme, të punohet në grupe më të vogla derisa nxënësi të kuptojë atë që kërkon.

Bashkëpunimin dhe në garën ndërmjet nxënësve

Në këtë moshë është e nevojshme të përdoren forma të larmishme dhe efektive bashkëpunimi dhe të nxiten gara ndërmjet nxënësve. Nxënësit duhet të nxiten të shkëmbejnë përvoja duke punuar në grupe dhe çifte, të marrin përgjegjësi për të kryer një detyrë duke nxitur përgjegjësinë si për të mësuar, por edhe për të ndihmuar shokun. Gara të jetë pjesë e punës së tyre në klasë, grup dhe në çift. Procesi i të mësuarit dhe të nxenit e gjuhës u jep mundësi të gjithëve për të fituar diçka. Nxënësit në këtë klasë konkurrojnë natyrshëm me njëri-tjetrin, si, për shembull, kush mbaron detyrën e pari, kush ka gjetur më shumë fjalë, kush ka ngjyrosur objektin e duhur etj. Forma të tilla pune u krijojnë nxënësve ndjenjën e arritjes së diçkaje dhe nuk përjashtojnë askënd.

Trajtimin e gabimeve

Gabimet e shpeshta gjatë mësimit të gjuhës së huaj në moshë të vogël janë normale. Njohja, ekspozimi i vazhdueshëm me gjuhën angleze dhe praktika e vazhdueshme do t'i afrojnë nxënësit gjithnjë e më shumë me gjuhën e huaj. Qortimi i shpeshtë nga ana e mësuesit mund të dëmtojë motivimin dhe ecurinë në gjuhë. Ndërhyrja e mësuesit bëhet e domosdoshme për struktura të caktuara gramatikore.

VI.VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI

Duke iu referuar standardeve të dhëna në program, mësuesi përcakton standarde të pritshme për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga dallimet e tyre individuale, gjuhësore, emotive dhe kulturore.

Edhe pse vlerësimi formal mund të mos jetë i detyrueshëm për këtë grup-moshë, është e këshillueshme që mësuesi të mbajë shënime të vazhdueshme për progresin e

nxënësve. Kjo bëhet në mënyrë sistematike dhe ndërthuret gjatë gjithë procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Mësuesi duhet t'u tregojë prindërve ecurinë e fëmijëve të tyre, por mbi të gjitha duhet të flasë me nxënësin për ecurinë e tij, duke e nxitur për punën e bërë. Kjo realizohet shumë thjeshtë, duke theksuar kryesisht anët pozitive dhe jo çka nuk ka mundur të arrijë. Asgjë nuk është më nxitëse se suksesi i arritur.

Mësuesi monitoron dhe qorton detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë.

Format e ndryshme e të larmishme të vlerësimit u krijojnë mundësi nxënësve për të konsoliduar njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi. Detyrat janë të studiuara, specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara.

Mësuesi u kushton vëmendje gabimeve dhe ndihmon në qortimin e tyre.

Kontrolli gojor, megjithë karakterin subjektiv, mbetet elementi më i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve në klasë. Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv dhe motivues, mund të përdoren tipat e mëposhtëm të ushtrimeve: Përsëritje, dialogje të shkurtëra, plotësime mbi figura, pyetje të tipit e saktë apo e gabuar, letra me zëvendësime fjalësh, teste që përfshijnë ngjyrat, ndërtim fjalish të thjeshta, tregime të thjeshta të përsëritura etj.

Mësuesi njëherazi i përdor këto vlerësime për të përmirësuar aspekte të ndryshme të punës së tij, shikon në mënyrë kritikë metodat e mësimdhënies dhe mban qëndrim po në mënyrë kritike për të përmirësuar frytshmërinë e tyre.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze edhe për këtë grup-moshë. Mësuesit, të cilët përdorin vetëvlerësimin në procesin e nxënies, duhet ta kryejnë në mënyrë shumë të përkallëzuar. Nxënësit mësohen të vlerësojnë atë çka është parashikuar të realizohet në program nga ana e tyre. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin progresiv të tyre.

Rëndësia e vetëvlerësimit nxit të mësuarit e pavarur gjatë gjithë jetës.

Në futjen e vetëvlerësimit gjatë procesit mësimor mund të ndiqen këta hapa :

- Mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë.
- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe mësuesi bën komentim përfundimtar.
- Puna në grupe nxit nxënësit të vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Nxënësit mbajnë shënim arritjet e tyre duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet e tij.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin i ndërgjegjëson të kuptojnë më mirë problemet e të mësuarit.

Në procesin e mësimin të gjuhëve të huaja vetëvlerësimi mund të përqendrohet në tri aspekte kryesore :

1. Në procesin e mësimin, që do të thotë vlerësimin e progresit të tyre, nivelin e arritur në secilin stad dhe suksesin ose mosesuksin në realizimin e detyrave dhe të objektivave të caktuar;
2. Në aftësitë e tyre komunikuese;
3. Në zotërimin e gjuhës, pra në numrin e fjalëve që di, përdorimin e strukturave gjuhësore dhe mënyrën si artikulon gjuhën.

KRITERET PËR HARTIMIN E TEKSTIT

Teksti “Gjuha angleze-4” për shkollat nëntëvjeçare do të jetë fryt i këtij programi të lëndës “Gjuha angleze për klasën e katërt” të ciklit të ulët.

Këshillohet që teksti “Gjuha angleze-4” të jetë i përbërë nga dy pjesë: nga libri i nxënësit dhe fletorja e punës, si dhe kasete për aspektin e të dëgjuarit.

Për hartimin e tekstit “Gjuha angleze-4” kërkohet të realizohen dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

Teksti “Gjuha angleze-4” të respektojë programin e hartuar për këtë klasë.

Zgjedhja dhe seleksionimi i materialit të bëhet në përputhje me një publik dhe mjedis specifik, pra nxënës të grup-moshës 10-11 vjeç. Prandaj metoda duhet t’u përgjigjet kërkesave dhe interesave të kësaj grup-moshe. Nëpërmjet saj nxënësi zbulon, vepron dhe bashkëvepron.

Autorët janë të lirë të vendosin temat atje ku ato mundësojnë përshtatje me qëllimet mësimore, gjuhësore, strukturore, kulturore dhe ndërthurjen e tyre.

Për të realizuar integrimin është e nevojshme që teksti të jetë i ndarë me njësi didaktike dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore. Materiali të jetë tërheqës, me personazhe të pëlqyera nga nxënësit e kësaj moshe, me ngjyra dhe figura të shumëllojshme që të mundësojnë nxitjen e nxënësve në nxënien e gjuhës angleze. Veprimtaritë të jenë të tilla që të nxisin imagjinatën dhe kreativitetin e nxënësve. Nëpërmjet mjeteve të mësipërme autorët të mbajnë parasysht futjen e elementeve të kulturës dhe të qytetërimit të gjuhës angleze, me anë të së cilës t’i mundësojë nxënësit njohjen me këtë kulturë.

Këshillohet që aparati pedagogjik i çdo mësimi të shoqërohet me rubrikat përkatëse, të cilat pasyrojnë integrimin aftësive gjuhësore duke shmangur nga teksti modelin e aparateve pedagogjike që kanë pamjen e një grupi pyetjesh të renditura njëra pas tjetrës dhe të ndara prej njëra-tjetrës. Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si: të lexuarit, të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit, duhet të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti të integruara në çdo orë mësimi si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike. Veprimtaritë në tekst të ndërtohen duke patur parasysht përdorimin e figurave, të këngëve të shoqëruara me veprime, ngjyrosjes, lojës me letra ngjitëse, dialogjeve të thjeshta etj.

Teksti të përmbajë: ushtrime me shkrim nëpërmjet historive, përrallave të shkurtëra, komenteve të thjeshta për figura, veprimtarive që forcojnë bashkëpunimin dhe jo konkurrencën, tabelave vetëvlerësuese që e lejojnë fëmijën të vetëqortohet.

Teksti i nxënësit të jetë i shoqëruar me libër mësuesi.

Rimarrja dhe riciklimi i njohurive, si një parim didaktik, duhet të jetë pjesë e mësimëve që do të përbëjnë këtë tekst, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e njohurive të dhëna në mësimet e mëparshme. Këshillohet një mësim përsëritës pas çdo cikli deri në 4 mësimet të reja.

Kërkohet që teksti “Gjuha angleze-4” të jetë një tekst, i cili zhvendos veprimtarinë e mësuesit gjatë mësimdhënies nga një mësimdhënie me mësuesin në qendër, në një mësimdhënie me nxënësin në qendër. Të ketë baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale dhe kolektive. T’i përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.

Një ndihmesë të madhe në përvetësimin e gjuhës së huaj jep funksionimi i të mësuarit të fjalëve të reja me të gjitha elementet bazë të fjalës apo të shprehjeve, duke realizuar trajtimin fonetik mbas çdo mësimi dhe kuptimet gramatikore, leksikore mbas çdo kapitulli.

Punët me shkrim nuk janë të detyrueshme si përbërëse e çdo ore mësimore, por të para si veprimtari që i përfshijnë nxënësit në veprimtari të gjera krijuese dhe zbatuese.